



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/96
Datë: 02.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli për bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile (referuar më tutje si Këshilli).
2. Këshilli është mekanizmi kryesor i përhershëm këshillues i cili do ta koordinoj të gjithë procesin e bashkëpunimit të Qeverisë me Shoqërinë Civile.
3. Përgjegjësitë kryesore të Këshillit janë:
 - 3.1. Koordinon procesin e bashkëpunimit të Qeverisë me Shoqërinë civile;
 - 3.2. Monitoron zbatimin e Strategjisë qeveritare për bashkëpunim me Shoqërinë civile;
 - 3.3. Ofron opinione, këshilla dhe rekomandime për projekt aktet ligjore, dokumentet strategjike dhe dokumentet e tjera që ndikojnë në punën dhe zhvillimin e OShC-ve;
 - 3.4. Ofron opinione dhe rekomandime për planet dhe raportet vjetore për shpërndarjen e fondeve publike në mbështetje të programeve dhe projekteve të OShC-ve.
4. Mënyra e punës së Këshillit rregullohet përmes Rregullave të punës së Këshillit për të cilat Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit është mandatuar t'i zhvillojë dhe të cilat do të miratohen në takimin e parë të Këshillit.
5. Këshilli përbëhet nga 29 anëtarë, nga të cilët 14 janë përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe 15 përfaqësues nga Shoqëria civile.
6. Nga përfaqësuesit e Shoqërisë civile, 14 prej tyre përzgjidhen nga vet organizatat e shoqërisë civile ndërsa 1 emërohet nga Platforma CiviKos.
7. Mandati i anëtarëve të Këshillit është katër (4) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

8. Procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes do të realizohen nga Platforma CiviKos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila do të monitorojë tërë procesin. Procedura për përzgjedhjen e përfaqësuesve nga shoqëria civile është e hapur, transparente dhe llogaridhënëse duke marrë parasysh nevojën për të siguruar përfshirjen e spektrit të gjerë të interesave që përfaqësohen nga organizatat e shoqërisë civile.
9. Këshilli drejtohet nga:
 - 9.1. Fitim Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit - kryesues;
 - 9.2. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit - zëvendës kryesues;
 - 9.3. Përfaqësuesi i emëruar nga Platforma CiviKos - bashkë kryesues.
10. Përfaqësuesit e tjerë të Qeverisë emërohen nga institucionet në vijim, të cilat përfaqësohen në nivel të Sekretarëve të Përgjithshëm dhe drejtorëve përgjegjës:
 - 10.1. Ministria e Administratës Publike, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.2. Ministria e Integritimit Evropian, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.3. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.4. Ministria e Financave, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.6. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.7. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Sekretari i Përgjithshëm, një anëtar;
 - 10.8. Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtar;
 - 10.9. Zyra Ligjore/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtar;
 - 10.10. Zyra për Planifikim Strategjik/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtar;
 - 10.11. Zyra për Komunikim me Publikun, Drejtori, një anëtar;
 - 10.12. Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Drejtori, një anëtar;
 - 10.13. Zyra Administrative/Zyra e Kryeministrit, Drejtori, një anëtar.
11. Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit shërben si Sekretariat i Këshillit dhe do të jetë në funksion për të zhvilluar dhe mirëmbajtur të gjitha aktivitetet e nevojshme për punën e Këshillit.
12. Për funksionimin efektiv dhe punën e suksesshme të këtij Këshilli, Sekretariati do të mbështetet nga Zyra e Kryeministrit në aspektin financiar dhe me burime njerëzore.
13. Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit dhe institucionet e tjera janë të obliguara që të zbatojnë këtë vendim.
14. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë